



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Arsyetim

Në bazë të vlerësimit të rregullt tremujorë të rreziqeve sistematike, i cili i përfshin të dhënat për tremujorin e tretë të vitit 2023, përfshirë edhe treguesit më të ri, rekomandohet që Këshilli i Bankës Popullore të sjell vendim për **rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve të bankave në Republikën e Maqedonisë për 0,25 pikë përqindje, nga 1,25% në 1,5% të përcaktuar më parë, e zbatueshme nga tremujori i parë i vitit 2025**. Norma e shtresës kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve të bankave ndaj klientëve nga vende tjera do të zbatohen në pajtim me lartësinë e normës së përcaktuar nga organi kompetent i vendit tjetër. Ndryshe, në pajtim me vendimet e mëparshme të Këshillit të Bankës Popullore, nga 1 gushti 2023 filloi të zbatohet norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet ndaj klientëve të Republikës së Maqedonisë në vlerë prej 0,5%, nga 1 janari 2024 deri 30 qershor 2024 kjo normë do të jetë 0,75%, nga 1 korriku deri 31 tetor 1% dhe në nëntor dhe dhjetor 2024 1,25%.

Rritja e normës së shtresës kundërciklike mbrojtëse të kapitalit edhe më tej ka për qëllim të veprojë në mënyrë parandaluese ndaj forcimit të mëtejshëm të qëndrueshmërisë së bankave dhe me atë të sigurojë stabilitet më të lartë financiar. Vendimi për rritjen e normës së shtresës kundërciklike mbrojtëse të kapitalit për ekspozimet e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut bazohet mbi vlerësimet për prezencën e mëtejshme të rreziqeve ciklike sistematike dhe periudhës së vazhduar të pasigurisë nga arritja e tyre, ndërsa në kushte të sistemit bankar të shëndoshë dhe stabil me profit të rritur dhe nivel të përshtatshëm të likuiditetit, kur rreziqet edhe më tej nuk pasqyrohen mbi bilancet e bankave vendase.

Vlerësimi i rrezikut sistematik ciklik për përcaktimin e sasisë së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut përfshin një analizë të treguesve bazë dhe shtesë për rrezikun sistematik. Që nga tremujori i tretë të vitit 2023, treguesi bazë është nën tendencën e tij afatgjatë me një devijim prej -5,8 p.p. **Propozimi për rritjen e normës së shtresës kundërciklike mbrojtëse të kapitalit bazohet mbi të dhënat shtesë për rrezikun sistematik, veçanarisht atyre që i referohen lëvizjeve makroekonomike dhe të tregut të patundshmërive të cilat mund në mënyrë indirekte të nxisin materializimin e rrezikut kreditor.** Prandaj, veçanarisht theksohet pasiguria nga lëvizjet e ardhshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve edhe përkrah ngadalësimit të vazhdueshëm të inflacionit gjatë vitit 2023, si dhe ndikimi i ritmeve ende të larta të çmimeve të patundshmërive në kushte të rritjes së mëtejshme solide të kredive për banesa. Rritja e vazhdueshme dyshifrore e nivelit të përgjithshëm të çmimeve shkaktoi shtrëngimin e kushteve financiare nëpërmjet rritjes së normave të interesit dhe shtrëngimit të kushteve kreditore, që paraqet një faktor të rrezikut të rëndësishëm për aftësinë kreditore të klientëve të bankave, pavarësisht ngadalësimit të rritjes. Norma vjetore e rritjes së çmimeve të patundshmërive një periudhë më të gjatë është dyshifrore edhe pse është ngadalësuar, ende është në nivel të lartë (11% në tremujorin e tretë të vitit 2023, 12,9% në të dytin, 18,8% në tremujorin e parë të vitit 2023 dhe 20,1% në tremujorin e katërt të

vitit 2022), që tregon për nevojën e monitorimit të kujdesshëm të tendencave edhe në periudhën e ardhshme. Edhe kreditë e banimit, edhe përkrah ngadalësimit, vazhdojnë të rriten me norma dyshifrore (10,1% në 30.9.2023, 10,7% në 30.6.2023, 11,4% në 31.3.2023 dhe 12,8% në 31.12.2022). Portofoli i kredive të banimit është me cilësi më të lartë dhe deri tash nuk ka shenja për arritjen e rrezikut kreditor, por kushtet e pasigurta makroekonomike i theksojnë rreziqet për periudhën e ardhshme dhe tregojnë për nevojën nga kujdesshmëria më e madhe nga ana e bankave dhe kujdes në zbatimin e masave makroprudenciale për shkak të forcimit të mëtejshëm të qëndrueshmërisë së bankave.

Sistemi bankar është i shëndoshë dhe stabil në kushte të materializimit të ulët sistematik të rrezikut kreditor, rritjes së profitueshmërisë dhe aftësisë paguese, si dhe mirëmbajtjen e nivelit përkatës të likuiditetit, që është e vërtetuar edhe nga gjetjet e testeve të rregullta të stresit për, kryesisht, rezistencën e lartë të bankave vendase ndaj goditjeve të mundshme. Në tremujorin e tretë të vitit 2023, norma e përshtatshmërisë u rrit në 18,4%, ndërsa portofoli kreditor është me cilësi të mirë, ku norma e kredive me probleme është e ulët dhe stabile me rreth 3%. Profitueshmëria e sistemit bankar është përmirësuar ndjeshëm, me rritje të konsiderueshme në fitimin, e cila në kushte të rritjes së normave të interesit dhe aktivës me interes, vjen kryesisht nga të hyrat e rritura me interes neto. Rritja e shpejtuar e fitimit kishte ndikim pozitiv ndaj treguesve bazë për profitueshmërinë dhe efikasitetin operativ të sistemit bankar, të cilët janë mjaft më të mira se mesatarja e tyre afatgjatë. Prandaj, ruajtja e normës më të lartë të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit nuk do të paraqiste barë për bankat e caktuara, veçanërisht ato që janë në pajtim me rregullativën, me zbatimin e normës së rritur do të fillojë pas 12 muajve nga miratimi, që ju jep hapësirë të mjaftueshme bankave që ti planifikojnë në mënyrë përkatëse pozitat e tyre kapitale dhe mënyrën e përdorimit të profitabilitetit të përmirësuar për këtë qëllim.

Banka Popullore do të vazhdojë me monitorimin e kujdesshëm të rreziqeve sistematike dhe do ta rivlerësojë lartësinë e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit në bazë të rregullt tremujore. Njëkohësisht, në rast të realizimit të konsiderueshëm të rreziqeve në bilanci të bankave, duke pasur parasysh natyrën e shtresës kundërciklike të kapitalit dhe udhëzimet e institucioneve relevante europiane, Banka Popullore mund ta vlerësojë edhe nevojën për çlirimin e pjesshëm ose të plotë të tij, si mbështetje për punën e bankave ndaj çdo skenari të pafavorshëm.